



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM

Nr 84 Datë 19.09.08

PER

Disa ndryshime në zërat e shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë 2008

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, ligjin nr.9836 dt. 26.11.2007 « Per buxhetin e Shtetit te vitit 2008», Udhezimin nr.4 dt.17.01.08 i M.F «Per zbatimine buxhetit te shtetit per vitin 2008».Udhezimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrise se Brendshme «Per zbatimin e buxhetit te qeverisjes vendore per vitin 2008», V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 «Miratimin e buxhetit te Bashkise dhe institucioneve te vartesis se per vitin 2008», Ligji nr. 9936 date 26.06.2008 «Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise» mbështetur në kompetencat që ka, mbas diskutimit të anëtarëve si dhe mbas miratimit të ndryshimit në zërat e shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë për vitin 2008 nga Kryetari i Bashkisë

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e zërave të shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë për vitin 2008 sipas tabelave bashkangjitur këtij p-vendimi.

2. Të miratojë rritjen e shpenzimeve operative të Bashkisë me vlerën 5.246.000-lekë. Kjo rritje do të përballohet në vlerën 2.210.000-lekë nga kursimet e shpenzimeve operative të Bashkisë për vitin 2008, kurse vlera prej 3.036.000-lekë paraqitet e detajuar si më poshtë me këtë strukturë buxhetore:

Shtohet	00	01110 05	Art. 6020000 (shp. operative)	+ 3.036.000 lekë
Pakësohet	00	01110 05	Art. 6000000 (shp. Paga)	- 104.000 lekë
Pakësohet	00	01110 05	Art. 2300000 (shp.invest)	- 2.932.000 lekë

3. Të miratojë rritjen e shpenzimeve për investime me vlerën 10.000.000-lekë, e cila do të përballohet nga rritja e planit të të ardhurave në zërin taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 5.000.000-lekë, ndërsa vlera prej 5.000.000-lekësh të tjera paraqitet e detajuar si më poshtë me këtë strukturë buxhetore:

Shtohet	00	06260 05	Art. 2310000 (shp. invest)	+ 5.000.000 lekë
Pakësohet	00	01110 05	Art. 2300000 (shp. invest)	- 868.000 lekë
Pakësohet	00	01110 05	Art. 2310000 (shp. invest)	- 595.000 lekë
Pakësohet	00	06260 05	Art. 2310000 (shp. invest)	- 137.000 lekë
Pakësohet	00	04530 05	Art. 2310000 (shp. invest)	- 3.400.000 lekë

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Personelit PAM. si dhe Drejtoria Juridike.

5. Me propozim të këshilltarëve u vendos që, lëvrimi i fondit prej 10.000.000 lekë për ndricimin e stadiumit të qytetit, të mos bëhet përpara se të bëhet transparenca e preventivit dhe e lidhjes së akt marrëveshjes me Federatën e Futbollit, në Këshillin Bashkiak.

6.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Raimonda Nase
Raimonda Nase